

THE ROLE AND IMPORTANCE OF CONTROL OVER PUBLIC ADMINISTRATION IN NORTH MACEDONIA

Lindita Neziri

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia,
lindita.neziri@unt.edu.mk, lindita_neziri@outlook.com

Abstract: Public Administration in North Macedonia like in any other country has important role in implementing government policies and offering public services. Given the importance of the administration, it is indispensable to control its activity as a whole.

Control of Public Administration means monitoring and evaluating acts and activities of the administration to ensure that public administration is functioning properly in accordance with positive laws.

The purpose of control is to identify errors and deficiencies that may appear in the Public Administration's (hereinafter PA) work and to eliminate them.

Control plays a significant role in: ensuring good governance, legality, improving administrative efficiency, effectiveness and accountability in the public sector, preventing corruption and mismanagement, building citizens' trust in state institutions which is essential for the functioning of a democracy...

North Macedonian positive legislation foresees internal and external control. Internal control is based on the principle of hierarchy, meaning that a higher administrative body oversee the legality of the acts of a lower administrative body within the administrative organisation. External control is carried out by specialised bodies such as: Parliament, Ministries, Inspections bodies, Courts, the Ombudsman, the Public Prosecutor, State Audit Office, etc.

There are several types of control over the administration, such as the following: political control, legal control, special control over the PA, financial control. Depending on the nature of the control being exercised, the authority responsible for conducting control is also designated.

This research examines the role and the importance of control over the work of PA in North Macedonia, it also evaluates how the types of control may contribute to transparency, efficiency, effectiveness and accountability of the public sector. Additionally, the study highlights the challenges and areas for improvement in the current system of PA control.

This paper offers recommendations for improving the quality and efficiency of the public administration to align it closely with European standards.

For the needs of this research, we use: descriptive- comparative methods, analysis of legal provisions, scientific doctrines including: scientific research, dissertations, academic literature and official websites.

Keywords: Public Administration, efficiency, control, legality, North Macedonia

ROLI DHE RËNDËSIA E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË MAQEDONINË E VERIUT

Lindita Neziri

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia,
lindita.neziri@unt.edu.mk, lindita_neziri@outlook.com

Abstrakt: Administrata Publike në Maqedoninë e Veriut, ashtu si edhe në çdo vend tjetër ka rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave shtetërore dhe ofrimin e shërbimeve publike. Duke pasur parasysh rëndësinë e administratës, është e patjetërsueshme të kontrollohet veprimtaria e saj në tërësi.

Kontrolli i Administratës Publike nënkupton mbyqyrje dhe vlerësim të akteve dhe aktiviteteve të administratës për të siguruar funksionimin e Administratës Publike ashtu siç duhet në pajtueshmëri me ligjet pozitive.

Qëllimi i kontrollit është të identifikohen gabimet dhe lëshimet që mund të shfaqen gjatë punës së Administratës Publike (më tutje AP) si dhe të eliminohen ato.

Kontrolli luan rol të rëndësishëm në: sigurimin e qeverisjes së mirë; ligjshmërisë; përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies në sektorin publik; parandalimin e korrupsionit dhe keqmenaxhimit; besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore që është thelbësore për funksionimin e demokracisë...

Legjislacioni pozitiv i Maqedonisë së Veriut parasheh kontroll të brendshëm dhe të jashtëm të AP-së.

Kontrolli i brendshëm bazohet në parimin e hierarkisë, që nënkupton se organet më të larta mbykqyrin ligjshmërinë e akteve të organeve më të ulëta administrative brenda organizatës administrative. Kontrolli i jashtëm kryhet nga organe të specializuara si: Parlamenti, Ministritë, organet e inspektimit, Gjykata, Avokati i Popullit, Prokurori Publik, Enti Shtetëror i Auditimit, etj.

Egzistojnë disa lloje të kontrollit mbi AP, si: kontrolli politik, kontroll ligjor, kontroll i veçantë mbi AP-në, kontrolli financiar, etj. Varësisht nga kontrolli që realizohet caktohet edhe organi që është përgjegjës për kontroll.

Punimi shqyrton rolin dhe rëndësinë e kontrollit mbi punën e AP në Maqedoninë e Veriut, vlerëson se si llojet e kontrollit mund të kontribuojnë në transparencë, efikasitet, efektivitet dhe llogaridhënie të sektorit publik. Për më tepër, punimi thekson sfidat dhe fushat për përmirësim në sistemin aktual të kontrollit të AP-së.

Punimi ofron rekomandime për përmirësim të cilësisë dhe efikasitetit të AP-së për të përafruar me standardet evropiane.

Për nevojat e punimit përdoren: metoda krahasuese-përshkruese, analiza e dipozitave ligjore, doktrina shkencore përfshirë: hulumtimet shkencore, disertacione, literature akaemike dhe web faqe zyrtare.

Fjalë kyçe: Administrata Publike, efikasitet, kontroll, ligjshmëri, Maqedonia e Veriut.

1. HYRJE

Maqedonia e Veriut është shtet demokratik. Aspekti thelbësor i funksionimit të shtetit demokratik dhe qeverisjes së mire padyshim është kontrolli mbi veprimtarinë e AP- së.

Në kuptimin organizativ, AP përfshin organet gjegjësisht institucionet që drejtojnë me punët publike. Këto mund të jenë institucione publike (shtetërore ose njësi të vetëqeverisjes lokale) dhe private (kur atyre u besohen kompetenca publike) (Neziri, 2024:101).

AP është pjesë e pandashme e shtetit, është aparat/mjet nëpërmjet të cilës zbatohen politikat shtetërore, ligjet dhe aktet nënligjore, ofrohen shërbime publike, realizohen të drejta dhe nevoja/qëllime në sfera të ndryshme shoqërore. Puna e AP-së bazohet në parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që do të thotë se çdo veprim dhe çdo akt administrativ duhet të bazohet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Gjithsesi, në praktikë mund të ndodh shkelje e parimit të ligjshmërisë dhe si rrjedhojë paraqiten parregullësi, lëshime apo gabime gjatë punës së AP-së. Që të sigurohet ligjëshmëria, përgjegjësia, kualiteti i punës, kufizimi i tejkallimit dhe keqpërdorimit të autorizimeve, është e domosdoshme të ushtrohet kontroll i akteve dhe aktiviteteve të AP-së. Kontrolli nënkupton monitorim, mbykqyrje, vëzhgim, kontrollim dhe vlerësim të aktiviteteve, akteve dhe sjelljeve për të garantuar ligjshmëri në kuptimin material dhe formal (Shasivari & Osmani 2023: 71-78).

Kontrolli përfshinë tri faza: në fazën e parë bëhet krahasim i të parashikuarës dhe të asaj që është realizuar; në fazën e dytë vlerësohen konstatimet në bazë të verifikimit të kryer dhe në fazën e tretë bëhet intervenimi i cili është i dobishëm vetëm kur duhet mënjeluar devijimi i konstatuar (Kryeziu, 2019:195). Objekt i kontrollit janë aktet, aktivitetet, mënyra e përdorimit të autorizimeve, etj.

Qëllim i kontrollit është identifikimi dhe eliminimi i lëshimeve/gabimeve/devijimeve që mund të paraqiten gjatë veprimtarisë së AP-së.

Kontroll i veprimtarisë së AP-së siguron: sundimi të ligjit, funksionim efikas, transparent dhe llogaridhënës të AP-së, ofrim të shërbimeve në mënyrë të ndershme, respektim të drejtave themelore të njeriut si dhe mbrojtje të vlerave demokratike (Azizi & Neziri, 2023: 35-60).

Hipoteza e punimit: *Kontrolli i AP-së mundëson funksionim efikas dhe funksional të AP-së.*

Pyetje kërkimore është: *Përse është e rëndësishme të ushtrohet kontroll mbi punën e AP-së?*

2. FORMAT DHE LLOJET E KONTROLLIT TË AP-SË

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e administratës publike për shtetin dhe qytetarët në tërësi, legjislativon pozitiv i Maqedonisë së Veriut (më tutje RMV) parasheh dy forma të kontrollit të punës së AP-së: kontroll të brendshëm dhe kontroll të jashtëm (Saliu, & Petkovski & Ismaili & Hajreti 2024: 267-285). Kontrolli i brendshëm nënkupton kontrollin që një organ i lartë administrativ ushtron ndaj një organi më të ulët administrativ brenda organizatës administrative duke u bazuar në parimin e hierarkisë. Kontroll i brendshëm inicohet nëpërmjet ankesës (si rezultat i palës së pakënaqur) ose sipas detyrës zyrtare (ex officio). Tipike për këtë lloj kontrolli është kontrolli që bëhet brenda ministrive dhe strukturave në vartësi të saj. Kontrolli i jashtëm realizohet nga organe të specializuara, të cilat i përkasin strukturave organizative të ndryshme që veprojnë jashtë organeve të administratës publike si psh: Kuvendi, Qeveria, Ministritë, organet e inspektimit, Enti për Revizion Shtetëror, Gjykata, Avokati i Popullit, Prokurori Publik etj.

Ekzistojnë disa lloje të kontrollit mbi administratën: kontrolli politik, kontrolli ligjor, kontrolli i veçantë mbi administratën dhe kontrolli financiar.

- **Kontrolli politik i AP-së** - është faktor i rëndësishëm në funksionimin e AP-së. Kryhet nga subjektet politike si: Kuvendi, Qeveria, partitë politike, opinioni publik. Formë e rëndësishme e kontrollit politik është kontrolli parlamentar. Mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatueshmërisë së politikave shtetërore dhe ligjeve është i rëndësishëm aq sa edhe procesi i miratimit të tyre. Krahas funksionit ligjvënës, funksioni i rëndësishëm i Kuvendit është edhe funksioni i kontrollit të ekzekutivit dhe AP në tërësi. (Neziri, 2024: 161). Përmes kontrollit, Kuvendi informohet rreth zbatimit praktik të politikave shtetërore. Kontrolli parlamentar realizohet nëpërmjet disa mekanizmave politik (parlamentar) që i kanë në dispozicion deputetët si përfaqësues të popullit:
 - **pyetjet e deputetit** - Deputetët pyesin gojarisht ose me shkrim, pyetjet i dedikohen bartësve të funksioneve publike që i zgjedh ose emëron Kuvendi (Rregullorja e Kuvendit, nenet 37-39). Pyetjet kanë karakter të një publiciteti sepse pas parashtrimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve nuk hapet asnjë debat (Aziri, 2012: 234-238). Deputetët zakonisht parashtrojnë pyetje, në rastet kur dëshirojnë që të marrin informacione nga Qeveria apo ministrat e caktuar për ndonjë aspekt konkret të punës së Qeverisë.
 - **interpelanca** - në rastet kur Kuvendi konstaton apo dyshon se Qeveria ka devijuar nga politikat e përcaktuara shtetërore, atëherë thërret Qeverinë apo ministrat e caktuar në interpelancë. Interpelanca ka të bëjë me punën e Qeverisë, një pjesë të saj ose me punën e organeve shtetërore. Iniciativë për interpelancë mund të marrin së paku 5 deputetë (Kushtetuta, neni 72). Deputetët që ndërmarrin një aktivitet të tillë zakonisht i takojnë opozitës. Interpelanca dorëzohet në formë të shkruar. Për dallim nga pyetjet e deputetëve me rastin e interpelancës edheherë jepet përgjigje me shkrim, përsëri hapet debat pas të cilit votohet. Diskutimi për interpelancën zgjat më së shumti një ditë pune. Subjekti të cilit i është paraqitur interpelanca ftohet në seancë dhe ka të drejtë ta arsyetojë përgjigjen e tij me shkrim ose të japë përgjigje me gojë për interpelancën e parashtruar (Rregullorja e Kuvendit, nenet 46-49).
 - **mocioni i mosbesimit** - teorikisht është mjeti më serioz kontrollues i Qeverisë nga Kuvendi. Nëpërmjet këtij veprimi Kuvendi tregon se ka humbur besimin ndaj Qeverisë. Çështjen e votëbesimit mund ta iniciojnë së paku 20 deputetë (Kushtetuta, neni 92). Efekti i përdorimit të këtij mekanizmi mund të jetë mosvotimi i besimit të Qeverisë që për pasojë mund të ketë edhe rënien apo shkarkimin e saj. Votimi i mosbesimit ndaj Qeverisë është një lloj sanksioni që Kuvendi e ndërmerr ndaj Qeverisë, si pasojë e mosrealizimit të programit, i cili më parë ka marrë besimin në Kuvend dhe si pasojë vjen deri tek shkarkimi i Qeverisë.
 - **Komisioni hetues** - mund të shërbejë si bazë për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë eventuale të funksionarit (bartës i ndonjë funksioni publik). Komisioni hetues ka për obligim të shqyrtoj ndonjë rast konkret, apo ndonjë dokumentacion, të përgatit raport të shkruar në lidhje me rastin konkret dhe ta prezantojë atë para Kuvendit.

Në mbykqyrjen e ekzekutivit dhe AP –së, rol të rëndësishëm luajnë edhe partitë politike gjegjësisht opozita.

Opozita mund të ngre shqetësime me çrast qytetarët informohen për gabimet/devijimet e Qeverisë. Sidoqoftë, opozita shpesh përballlet me sfida për të realizuar kontrole efektive.

Rol të rëndësishëm në realizimin e kontrollit politik luajnë edhe mediat dhe shoqëria civile. Mediat janë kanal i rëndësishëm për informim. Ata informojnë qytetarët duke raportuar në lidhje me shkeljet apo abuzimet e mundshme, korrupsion apo veprime tjera që mund të dëmtojnë interesat e qytetarëve.

Qytetarët kontrollojnë AP ashtuqë organizojnë protesta dhe aktivitete tjera për të kërkuar llogaridhënie.

- **Kontrolli ligjor** – është kyç në funksionimin e shtetit demokratik. Nëpërmjet kontrollit ligjor sigurohet që AP do të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet pozitive në vend dhe nuk do të shkelen liritë dhe të drejtat individuale të qytetarëve nga ana e AP-së. Kontrolli gjyqësor konsiderohet mjet efektiv në mbrojtjen e drejtave individuale të qytetarëve nga abuzimet ose shkeljet eventuale nga ana e administratës. Institucionet përgjegjëse për kontroll ligjor janë Gjykatat, në veçanti Gjykata Kushtetuese e cila është përgjegjëse për të verifikuar nëse aktet nënligjore dhe ligjet janë në përputhje me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese ka fuqi të shpall të pavlefshme veprimet, politikat, aktet që janë në kundërshtim me Kushtetutën.
- **Kontrolli i veçantë mbi administratën** - kryhet nga organe të posaçme shtetërore, si: Avokati i Popullit ose Prokuroria publike. Këto subjekte kanë për detyrë të mbrojnë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve nëse ata shkelen nga administrata shtetërore apo organet e organizatave tjera që kanë autorizime publike. Këto subjekte i kushtojnë kujdes mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjestarëve të bashkësive në organet e administratës shtetërore, organet e njësisë të vetadministrimit lokal dhe në institucionet e shërbimit publik (Kushtetuta, neni 77).

- **Kontrolli financiar** - Përmes kontrollit financiar kontrollohet mënyra se si shfrytëzohet buxheti publik nga organet e AP-së, identifikohen parregullsitë, sjelljet e paligjshme, rastet e keqpërdorimit të detyrës, rastet e mundshme të korrupsionit e të ngjashme. Kontrolli financiar kryhet nga organet e specializuara shtetërore si: Enti për Revizion Shtetror, Drejtoria e të Ardhurave Publike, etj. Nëse identifikohen shkelje/devijime, rekomandohen masa korrigjuese, por ndonjëherë ndodh që çështja të dërgohet tek autoritetet e drejtësisë. Kontrolli financiar siguron stabilitet ekonomik, menaxhim të ligjshëm dhe efikas të burimeve financiare, funksionim të një AP të përgjegjshme.

3. ROLI DHE RËNDËSIA E KONTROLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

AP luan rol të rëndësishëm në funksionimin e shtetit ligjor. Nëpërmjet kontrollit të AP arrihet:

- ❖ Transparenca - qytetarët mbeten të informuar rreth gabimeve, lëshimeve, devijimeve, abuzimeve të Qeverisë dhe AP në tërësi;
- ❖ Përgjegjshmëri dhe llogaridhënie - kontrolli mundëson që funksionarët shtetëror dhe nëpunësit administrativ të veprojnë në përputhje me ligjin;
- ❖ Parandalim i korrupsionit - kontrolli është mjet i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, keqpërdorimit të kompetencave apo abuzimeve të ndryshme nga ana e funksionarëve shtetëror dhe nëpunësve administrative;
- ❖ Përmirësim i cilësisë së shërbimeve - nëpërmjet kontrollit identifikohen lëshimet, mangësitë në shërbimet publike dhe si pasojë merren masa për përmirësim dhe ofrim të shërbimeve në mënyrë më efikase dhe cilësore;
- ❖ Qeverisje e mire dhe sundim i shtetit ligjorë - kontrolli i AP siguron që AP vepron në përputhje me dispozitat Kushtetuese dhe ligore që është kusht thelbësor për një shoqëri stabile;
- ❖ Rritje e besimit të qytetarëve në AP – kur AP mbykqyret, qytetarët fitojnë besim tek institucionet shtetërore që është e domosdoshme për funksionimin e shtetit demokratik.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Administrata është pjesë e aparatit shtetëror nëpërmjet së cilës zbatohen politikat publike të ndërmarra nga Qeveria. Duke pasur parasysh rëndësinë e administratës për shtetin dhe qytetarët në tërësi është e patjetërsueshme kontrolli i vazhdueshëm mbi veprimtarinë e saj.

Kontrolli ka për qëllim:

- ndërtimin e një AP funksionale, efektive, transparente dhe të qëndrueshme,
- sundimin e ligjit,
- mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve,
- ndalimin e keqpërdorimeve/abuzimeve dhe sjelljeve joligjore të funksionarëve shtetëror dhe nëpunësve administrative,
- ruajtjen e besimit të qytetarëve në efektivitetin e AP, etj.

Ndonëse në teori funksionojnë mekanizmat e kontrollit të AP-së, zbatimi i tyre në praktikë has në sfida. Korrupsioni, nepotizmi dhe ndikimi politik mbeten sfida serioze në efektivitetin e kontrollit të AP-së. Për të forcuar sistemin e kontrollit, duhen eliminuar pengesat që pengojnë funksionimin e tij të plotë. Në RMV, reforma e AP-së vazhdon tashmë për vite të tëra, por pa arritur të krijohet një administratë moderne dhe profesionale. Qeveria dhe institucionet e tjera, duhet të gjejnë rrugë të reja për një qeverisje funksionale në shërbim të qytetarëve. Për të rritur efikasitetin e punës së administratës dhe besueshmërinë e qytetarëve në AP, është e patjetërsueshme luftim i dukurive negative si: marrje e ryshfetit, vjedhje, neglizhencë, politizim, nepotizëm dhe antivlera tjera; promovim i vlerave etike në punë si dhe edukim i qytetarëve në ndërtim të një shoqërie të pakorruptuar.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Azizi, A. & Neziri, L. (2023). EVALUATION OF PUBLIC ADMINISTRATION REFORMS IN NORTH MACEDONIA FROM THE PERSPECTIVE OF EUROPEAN COMMISSION'S ANNUAL PROGRESS REPORTS, HKJU-CCPA, vol.23. (1), p. 35–60 Link: <https://www.ccpa-journal.eu/index.php/ccpa/issue/current>.

Azizi, A. & Neziri, L. (2022). RULE OF LAW IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA OVER THE LAST DECADE EVALUATED BY INTERNATIONAL AUTHORITIES. Balkan Social Science Review Vol 20. p. 7-27. Link: <https://js.ugd.edu.mk/index.php/BSSR/article/view/5497>

Aziri, E. (2012). SISTEMI POLITIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: FORMIMI, SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT DEMOKRATIK, UEJL, Tetovë.

Berisha, F., & Zejneli, J., & Salju, A.(2020). E DREJTA DHE ADMINISTRATA PUBLIKE, Shkup.

- Davitkovski , B., & Pavlovska-Daneva, A.(2018).E DREJTA ADMINISTRATIVE, PJESA E PARË, E DREJTA MATERIALE, Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë”, Shkup, fq. 14, 95-96. E disponueshme online në: <https://www.ukim.edu.mk/>
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut me amendamentet e Kushtetutës I-XXX, e disponueshme online në: <http://www.sobranie.mk>
- Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e disponueshme online <https://www.sobranie.mk/>
- Ligji për deputetët, “Gazeta Zyrtare e RMV-së,nr 84/2005, 161/2008,51/11,109/14,140/18 e disponueshme <https://w.w.sobranie.mk/>
- Neziri, L. (2024). *PUBLIC ADMINISTRATION AND THE STATE. KNOWLEDGE - International Journal* , 63(1), 99–102. Retrieved from <https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/6670>
- Neziri, L. (2024). THE STATE AS A SPECIFIC ORGANISATION OF SOCIETY: STATE ORGANISATION OF NORTH MACEDONIA. *KNOWLEDGE - International Journal* , 62(1), 147–151. Retrieved from <https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/6572>
- Neziri, L. (2024). THE ROLE AND PLACE OF THE PARLIAMENT IN THE POLITICAL SYSTEM OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA: RELATIONS BETWEEN THE LEGISLATIVE POWER AND THE EXECUTIVE POWER. *KNOWLEDGE - International Journal* , 62(1), 159–162. Retrieved from <https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/6574>
- Neziri, L. (2022). ANALYSIS OF THE ELECTORAL SYSTEM FOR PRESIDENTIAL ELECTIONS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA: ADVANTAGES AND DISADVANTAGES. *KNOWLEDGE - International Journal* , 51(1), 251–256. Retrieved from <https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/5061>
- Neziri, L., (2022). THE NECESSITY TO CHANGE THE MACEDONIAN ELECTORAL SYSTEM FOR PARLIAMENTARY ELECTIONS, Në 13th International Scientific Conference, “International dialogue: east-west”, Sveti Nikole, e disponueshme online ne Linkun: <https://konferencii.msu.edu.mk/mdiz/spisanija/megunaroden-dijalog-2022/>
- Neziri, L. & Azizi , A. (2018). PUBLIC ADMINISTRATION REFORMS IN MACEDONIA: THE ANNUAL PROGRESS REPORTS OF THE EUROPEAN COMMISSION 2011-2018”. In Governance in Public Sector. Challenges and Perspectives (proceedings of the third conference on FCSS), pp. 143-158, SEEU, Tetovo, R. of Macedonia, ISBN: 978-608-248-027-5.
- Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 2008, e disponueshme online në: <https://www.sobranie.mk>.
- Saliu, A., & Ismaili, D., & Petkovski, A., & Hajretin , V.(2024). HYRJE NË ADMINISTRIM PUBLIK, Shkup.
- Shasivari, J. & Osmani,A. (2023). E DREJTA ADMINISTRATIVE, PËR ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL PËR PROFILIN ARSIMOR, TEKNIK JURIDIK, Shkup e qasshme online në <https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/>
- Shasivari, J.(2020). FILLET E SË DREJTES, S, Logos-A, fq. 79-112.
- Shasivari, J. (2020). E DREJTA KUSHTETUESE, Shkup, fq. 272-273.
- .